Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Nërastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurimoferte, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 3;jo*

ç. *Deklaratëmbi përmbushjen eSpecifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratëmbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 8/1;*

f. *Deklaratëmbi disponueshmërinëe mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- **Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 12)**

2.2. Per kapacitetin ekonomikë dhe financiarë:

1. Kopje të bilanceve të tre viteve të fundit ushtrimor (2017-2018-2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara prej tyre. Gjithashtu bilancet duhet të jenë të shoqeruara nga akt ekspertizë e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar, kur janë kushtet e percaktuara në nenin 41 germa c të ligjit nr 10091 date 05.03.1999 (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).

2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku mesatarja të jetë në një vlerë jo më të vogël 50 % e fondit limit që prokurohet. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të percaktuara në akt marrëveshje).

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas percaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar); Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

2.3 Per kapacitetin teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një kontratë të vetëm me vlerë jo me te vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë tri viteve të fundit.

- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e kontratave të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit dhe qe eshte realizaur gjate tre viteve te fundit.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara **me ente publike**,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vleresimi
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;

- b) Për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vleresimi
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore;

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Operoret ekonomike duhet te disponojne **Liçensen e Shoqerise**, e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”.

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme

- c. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P – 1 A
- N.P – 7 A
- N.P – 12 A

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S - 1A
- N.S - 18 A

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2. Një punësim mesatar i të paktën **65 (gjashtedhjetë e pesë)** punonjes, për periudhën **Shtator 2020– Dhjetor 2020**, të vërtetuar me;
 - a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Shtator 2020– Dhjetor 2020**.
 - b. Liste pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Shtator 2020– Dhjetor 2020**, konfirmuara nga institucionet perkatese.
 - c. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisëper periudhen **Shtator 2020– Dhjetor 2020**stafi inxhinierik si më poshtë:
 - 1(një) inxhinierë Ndërtimi
 - 1(nje) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshaidr/Gjeomatik.
 - 2(dy) inxhinier Hidroteknik
 - 1(nje) inxhinier Mjedisi
 - 1(nje) inxhinier Mjedisi(Profili trajtim ujrave)
 - 1(një) inxhinierë Mekanik
3. Krahas stafit te mesiperm te kete te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:
 - 2 (dy) punonjës teknik Ndërtimi
 - 1 (nje) punonjës teknik Hidraulik

- 1 (nje) punonjës teknik Gjeometer
- 1(nje) punonjës teknik Mekanik
- 1 (nje) punonjës teknik Topograf
- 2 (dy) punonjës saldator

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata noteriale e punës e vlefshme, deftese e shkolles profesionale / ose vertetim i lëshuar nga shkolla profesionale shtetërore per secilin punonjes. Stafi i mësipërm te figuroje ne listepagesat e shoqërisë per periudhen **Shtator 2020– Dhjetor 2020** Mos paraqitja e kontratave te nenshkruara perpara noterit mes paleve kontratore do te jete kusht skualifikues:*

Ne rastin e paraqitjes se kontratave kolektive detyrimisht te jene konform nenit 160 te Kodit te Punes sipas parashikimeve ligjore ne fuqi.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës Karpentier
- 2 (dy) punonjës Murator
- 1 (nje) punonjës Hekur kthyes
- 1 (dy) Hidraulik

- *Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata noteriale e punës e vlefshme; deshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik, (të vlefshme), deshmitë e aftesise profesionale deftese/ certifikate/diplome si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë per periudhen **Shtator 2020– Dhjetor 2020**.*

5.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht: 4(kater) Eskavatorist/Manovrator, 5(pese) shofere, Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata noteriale e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), deshmitë e aftesise Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisëper periudhen **Shtator 2020– Dhjetor 2020**.

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1(një) mjek** të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense per ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë përperiudhen **Shtator 2020– Dhjetor 2020**. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një punonjes që përmbush kriteret për të qenë koordinator për **realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve**, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi

Dokumenta Standarde të Tenderit

(specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

8.Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit.

9.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10).

Nr/R	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamiona veteshkarkues kapacitet mbajtes(10-12 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
2	Kamionçine kapacitet mbajtes(1.5-2 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
3	Kamiona veteshkarkues kapacitet mbajtes(3-5 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
4	Sistem Wellpoint/ekuivalent për heqje ujrash	2 copë	Pronësi ose me qera
5	GPS	1 copë	Pronësi ose me qera
6	Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
7	Kamion me Vinckapcitet mbajtes(6 - 10 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
8	Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
9	Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
10	Minieskavator me zinxhir	1 copë	Pronësi ose me qera
11	Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
12	Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qera
13	Betonjere kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
14	Kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
15	Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
16	Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
17	Mini fadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
18	Autopompe per hedhje betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
19	Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
20	Armature per betonet	1000 m2	Pronësi ose me qera
21	Rrul me peshe 0-1 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
22	Rrula 5-12 tone	1 copë	Pronësi ose me qera
23	Autobot per KUZ	1 copë	Pronësi ose me qera
24	Aparat saldimi me elektrofuzion per ngjitje tub plastik	1 copë	Pronësi ose me qera

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 Per miratimin e rregullores ”Per sigurine ne kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 65 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 10 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë shoqëruar me fotot përkatëse.

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 10) të shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:

- a) **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës:** Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, plus taksa e mjetit dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme) si dhe certifikaten e transportit, leje transporti, licence transporti të leshuara nga autoritetet përkatëse për subjektin.

ose

b) **Kontratën e marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jete specifike perobjektin që prokurohet dhe afatin e realizimit të kësaj kontrate.

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (mjetet me goma) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, plus taksa e mjetit dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) si dhe certifikaten e transportit nga autoritetet përkatëse për vetë dhe të tjerë, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

Për secilin prej mjeteve të paraqiten fotografi të tyre.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese duhet të përmbajë vendndodhjen e sakte të mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi.

- **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve.**

- :

12. Kandidati ofertues duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme: (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike secili nga operatorët duhet të zotërojë certifikatat e mëposhtme në përputhje me punimet e marra përsiper).

Për të garantuar punime me cilësi dhe me seriozitet operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme (ose të njëvlefshme me to):

- **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë“ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim për garantimin e cilësisë në punime.
- **OHSAS 18001:2007** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë“ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë. Osecertifikatë ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare **ISO 45001-2018**.
- **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit“ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim, për mbrojtjen e mjedisit dhe të sistemit.

- **ISO 1452-1:2009** mbi “Ndertimin e sistemeve te tubacioneve per transportimin e ujit, mbi dhe nen tokesore” per pjesen e kanalizimeve me presion mbi toke per tubat .
- **BS ISO 39001:2012** mbi “Sigurine ne trafikun rrugor”.
- **ISO 3834-4 2005 mbi** Sistem i Menaxhimi i Sigurise per Saldimet (e vlefshme).

13. Operatorët ekonomikë ,duhet kenë apo që mund t’i vihen në dispozicion

1(një) nje thyerje materiale inert e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B,

1(një) fabrike betoni e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B

Në rastin kur ka një kontratë qiraje/furnizimi me prodhuesin, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

14. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimime materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

a.Tubo te brinjezuar HDPE SN8 . Kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës,leje mjedisore kodi KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi I produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi I plastikes) dhe certifikatëne cilësisë ISO 9001/ekuivalente e vlefshme.

b)Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet kontrata paraprake e furnizimi te vlefshme dhe katalogu përkatës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

15. Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003 , nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B “ Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”.

16.Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzoj analizë teknike për të gjithë e preventivit të ofertës. Mos paraqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.

17. Cdo ofertues do te paraqese PLANIN E SIGURISE NE KANTIER

Per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003.sipas kerkesa, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

18.Deklarate e Operatorit Ekonomik se oferta e tij eshte ne perputhje me Projektin, specifikimet teknike, kushtet e kontratës, menyren e financimit si dhe te dhenat e tjera ne dokumentat e tenderit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: Bashkelidhur

Specifikimet Teknike tëMaterialeve: Bashkelidhur

Dokumenta Standarde të Tenderit

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Bashkelidhur

**Objekti: Ndertim i rrjetit kryesor KUZ ne fshatin Lapardha si vazhim I projektit te realizuar ne vitin 2019 "Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Lapardha (Lapardha 1 dhe Lapardha 2)"
,Njesia Administrative Otlak**

Dokumenta Standarde të Tenderit

Kanali K1 -22 ml (Lapardha 1)						
Nr	Analiza	Pershkrimi I punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2.15/a	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategoria IV, h = 1.5 m	m3	14.56		
2	3.59/c	Germim themel i vecuar, gropa sip. 10-30 m ² , toke e forte me h=1.5m	m3	1.5		
3	2.261	Shtrese rere nen dhe mbi tub	m3	7.52		
4	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	8.06		
5	2.19/a	Mbushje ngjeshje dheu t. forte	m3	8.54		
6	3An/1t	FV tubo te brinjezuar HDPE SN 8 φ 315 mm	ml	22		
7	Analiza	Tubo celiku Ø351 t= 6cm	ton	0.33		
8	2.111/2	Mure betoni C - 12/15	m3	0.4		
9	2.575	Ndertim pusete 1x1x1.5 h-1.5 m	cope	1		
10	3.212/b	Shtrese stabilizanti t-10 cm	m2	17.6		
Shuma 1						
Kanali K2 -46 ml (Lapardha 1)						
Nr	Analiza	Pershkrimi I punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2.15/a	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategoria IV, h = 1.5 m	m3	36.9		
2	3.59/c	Germim themel i vecuar, gropa sip. 10-30 m ² , toke e forte me h=1.5m	m3	4.5		
3	2.261	Shtrese rere nen dhe mbi tub	m3	21.62		
4	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	24.62		
5	2.19/a	Mbushje ngjeshje dheu t. forte	m3	23.24		
6	3An/1t	FV tubo te brinjezuar HDPE SN 8 φ 315 mm	ml	46		
7	2.575	Ndertim pusete 1x1x1.5 h-1.5 m	cope	3		
8	3.212/b	Shtrese stabilizanti t-10 cm	m2	36.8		
Shuma 2						
Kanali K3 -7 ml (Lapardha 1)						
Nr	Analiza	Pershkrimi I punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2.15/a	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategoria IV, h = 1.5 m	m3	4.8		
2	3.59/c	Germim themel i vecuar, gropa sip. 10-30 m ² , toke e forte me h=1.5m	m3	1.5		
3	2.261	Shtrese rere nen dhe mbi tub	m3	3.29		
4	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	6.08		
5	2.19/a	Mbushje ngjeshje dheu t. forte	m3	3.08		
6	Analiza	Prishje shtrese asfaltobetoni	m2	4.55		
7	3.226/2	shtrese a/betoni me granil gure kave 5 cm me makineri	m2	4.55		
8	3An/1t	FV tubo te brinjezuar HDPE SN 8 φ 315 mm	ml	7		
9	2.575	Ndertim pusete 1x1x1.5 h-1.5 m	cope	1		
10	3.212/b	Shtrese stabilizanti t-10 cm	m2	0.5		
Shuma 3						

Dokumenta Standarde të Tenderit

Kanali kryesor I-452 ml (Lapardha 1)						
Nr	Analiza	Pershkrimi I punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2.15/a	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategoria IV, h = 1.5 m	m3	435.5		
2	3.59/c	Germim themel i vecuar, gropa sip. 10-30 m ² , toke e forte me h=1.5m	m3	28.5		
3	2.261	Shtrese rere nen dhe mbi tub	m3	212.44		
4	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	223		
5	2.19/a	Mbushje ngjeshje dheu t. forte	m3	200		
6	3An/3t	FV tubo te brinjezuar HDPE SN 8 φ 500 mm	ml	452		
7	2.575	Ndertim pusete 1x1x1.5 h-1.5 m	cope	19		
8	3.212/b	Shtrese stabilizanti t-10 cm	m2	361.6		
Shuma 4						
Kanali kryesor I-774 ml (Lapardha 2)						
Nr	Analiza	Pershkrimi I punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2.15/a	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategoria IV, h = 1.5 m	m3	736.5		
2	3.59/c	Germim themel i vecuar, gropa sip. 10-30 m ² , toke e forte me h=1.5m	m3	37.5		
3	2.261	Shtrese rere nen dhe mbi tub	m3	452.79		
4	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	251.55		
5	2.19/a	Mbushje ngjeshje dheu t. forte	m3	336.69		
6	3An/3t	FV tubo te brinjezuar HDPE SN 8 φ 500 mm	ml	774		
7	Analiza	Mbushje shtrese zhavorri dhe ngjeshje	m3	1372		
8	2.575	Ndertim pusete 1x1x1.5 h-1.5 m	cope	25		
9	3.212/b	Shtrese stabilizanti t-10 cm	m2	462.4		
Shuma 5						
Shuma I+II+III+IV+V						
tvsh 20 %						
Shuma totale						

Shtojca15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

<Emri>

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

Dokumenta Standarde të Tenderit

bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si

rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
